



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

---

Nr. 128 Prot

Tiranë, më 27.07 2009

**VENDIM Nr. 10 dt. 20.07.2009**

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 20.07.2009, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara nga Këshilli Shkencor pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës:

**VENDOSI:**

Sipas pikave të rendit të ditës:

**I. Të miratojë projektet:**

1. **Miratohet** projekti "Kompleks reaktiv tek Fusha e Zezë"(sipas Kontratë Bashkëpunimi midis Mbretit Leka I Zogu dhe z. Alban Xhillari).
2. **Miratohet** projekti "Rikualifikim i lulishtes Millenium".
3. **Miratohet** projekti "Lokal Valle Verde".
4. **Miratohet** "Projekt përshtatje kompleksi i banimit multifunksional, i Vasil Merdanit, zona tampon, Berat".
5. **Miratohet** projekti i rishikuar i "Projekt restaurim i banesës së Dhimitër Ikonomit, lagjia Goricë, Berat".
6. **Miratohet** Projekt rikonstruksioni banesa Thanas Tapia, Berat
7. **Miratohet me shumicë votash:** "Projekt i rikonstruksionit të banesës Besnik Guri, Elbasan".
8. **Miratohet** projekti "Restaurim i kullës juglindore në kalanë e Elbasanit"( Të ndiqen procedurat ligjore për marrjen me qera të kullës juglindore nga z. Besnik Guri)
9. **Projekti** "Shtesa e verandës dhe Guzhinës, lokali "Valle Verde".  
**Miratohet** Mbyllja e verandës.(Shtesa e guzhinës të diskutohet në mbledhjen e rradhës).

## II. Do të diskutohen në Mbledhjet e ardhshme të tërlesat:

1. Kërkesë për rikonstrukcion banese me pronar Fatmir Lame, Elbasan.
2. Kërkesë për ndërtim banese pranë lagjes kala, Elbasan. Fidelino Halo.
3. Kërkesë për leje rikonstrukcioni ish ambientet e Institutit të Arkeologjisë dhe palestrën sportive në zgjatim të saj. (Dokumentacioni i kërkuar është pranë IMK).
4. Projekt përshtatje fasade për banesën me pronar Zenel Sheshalliu, Zona tampon, Berat.
5. Projekt rikonstrukcioni për banesën e Vangjel Felahut, lagja 10 Korriku, Berat.
6. Projekt restaurimi i kompleksit të familjes Nikolin Ujka, Shkodër.
7. Mbulimi tek kinema "Millenium"

## III. Do të diskutohen në mbledhjen e ardhshme pika IV dhe V e rendit të ditës:

### Diskutimi i projekteve të cilat presin financim:

1. Projekt idenë e rikonceptimit tërësor të mozaikut të Tiranës.
2. Projekti i restaurimit dhe rihabilitimit të kishës në Derven, Laç.
3. Projekti i restaurimit të Teqes së Sheh Dyrrit, Tiranë.
4. Preventivi i punimeve për Teqenë e Frashërit, Gjirokastrë, relacion, preventiv. (Vazhdim)
5. Projekti i konsolidimit të pikturës murale në kishën Shën Mëria, Dhërmi.
6. Restaurimi i banesës së At Gjergj Fishtës, Lezhë.
7. Restaurimi në qytetin "Nikaia", Klos, Mallakastër.

### Diskutimi i kërkesave që duhen parë nga ana ligjore.

1. Mbetet të diskutohet në një mbledhje tjetër Projekt-studim për rikonstrukcionin e kompleksit të familjes Shkarpa, kala Berat. (Kërkohej konsolidimi i rrugës së dëmtuar si pasojë e gërmimit.)
2. "Projekt Zbatim Lulishtja Millenium" pritet të diskutohet në mbledhjet e rradhës pas përfundimit të procedurës juridike.

### Diskutimi i kërkesave për licensë:

1. Kërkesë e znj. Adelina Baballëku, për pajisje me licensë të kat.  
**Kat. A. Projektim e zbatim në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës, për nënkategoritë:**  
A/2. Projektim dhe zbatim në restaurimin e monumenteve të arkitekturës antiko – mesjetare, (nuk përfshihen në këtë pikë monumentet e përmendura në pikat A/3, A/4).  
A/3. Projektim dhe zbatim në restaurimin e ndërtimeve civile, monumente të

katëgorisë së parë dhe të dytë.

A/4. Projektim dhe zbatim në restaurimin e Qendrave Historike.

2. Kërkesa e Sokrat Kuvarati, për pajisje me licensë të

**Kat. B. Restaurim i veprave të artit dhe objekteve muzeale, për nënkategoritë:**

B/2. Projektim dhe zbatim në restaurimin e afreskeve.

B/3. Projektim dhe zbatim në restaurimin vepra të arti në dru.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR  
ARDJAN TURKU**



**SEKRETAR I KKR  
PROF. DR. VALTER SHTYLLA**

